

DHOMA E POSAÇME E  
GJYKATËS SUPREME TË  
KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË  
LIDHEN ME AGJENCINË  
KOSOVARE TË  
MIRËBESIMIT

SPECIAL CHAMBER OF THE  
SUPREME COURT OF KOSOVO  
ON KOSOVO TRUST AGENCY  
RELATED MATTERS

POSEBNA KOMORA  
VRHOVNOG SUDA  
KOSOVA ZA PITANJA  
KOJA SE ODNOSE NA  
KOSOVSKU  
POVERENIČKU AGENCIJU

**ASC-10-0054**

Në kontestin e

*Paditësit/Ankuesit*

1. [REDACTED] nga fshati Preoc, Prishtinë
2. [REDACTED] nga fshati Preoc, Prishtinë
3. [REDACTED] nga fshati Preoc, Prishtinë
4. [REDACTED] nga fshati Preoc, Prishtinë
5. [REDACTED] nga fshati Uglar, Fushë Kosovë
6. [REDACTED] nga fshati Bërnicë e Poshtme, Prishtinë

Të gjithë të përfaqësuar nga [REDACTED] nga fshati Preoc,  
Prishtinë

Kundër

*Të Paditurit*

**1. Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)**, Rr. Ilir Konushevci 8, Prishtinë

**2. NSH** [REDACTED], Fushë Kosovë, (e njohur si **NSH** [REDACTED],  
Miradi të Epërmë)

**3. Ndër e Re** [REDACTED]

[REDACTED] Prishtinë

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaqme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS) i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Mr.sc Sahit Sylejmani, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësve/Ankuesve kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 29 qershori

2010, SCC – 09 - 0248, pas seancës vendimmarrëse të mbajtur më 1 dhjetor 2010, lëshon këtë

### **AKTVENDIM**

- 1. Ankesa është pjesërisht e bazuar. Lidhur me refuzimin e padisë ndaj të Paditurit të parë dhe të dytë, aktvendimi i Trupit Gjykues vërtetohet.**
- 2. Sa i përket refuzimit të padisë ndaj të Paditurit të tretë, aktvendimi i Trupit Gjykues në lëndën SCC – 09 – 0248 të datës 29 qershor 2010 anulohet.**
- 3. Urdhërohet Trupi Gjykues – në përbërjen e tij të plotë – ta rigjykojë lëndën lidhur me të Paditurin e tretë.**
- 4. Ankuesit obligohen bashkërisht të paguajnë taksat gjyqësore në shumën prej 60 eurosh për procedurën ankimore në Dhomën e Posaçme.**

#### **Rrethanat procedurale dhe faktike**

Më 31 dhjetor 2009, Paditësit kanë parashtruar një Padi pranë DHPGJS-së duke kërkuar vërtetimin e të drejtës së tyre pronësore mbi ngastrën kadastrale 434, tek lokacioni "Bare" në zonën kadastrale "Preoce" me sipërfaqe prej 0.83,82 ha.

Më 28 gusht 2009, AKP-ja ka parashtruar një shkresë me anë të së cilës i është referuar një kërkese të më hershme nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) për pezullimin e të gjitha procedurave në lidhje me NSH [REDAKTUE] nga Miradi e Epërme, e njojur gjithashtu si NSH [REDAKTUE] [REDAKTUE] nga Gornje Dobrevo / Miradi e Epërme me ç'rast nga Paditësit është shënuar si i Padituri kryesor në këtë padi. AKP-ja ka pohuar se në vitin 2007 AKM-ja e ka njoftuar Dhomën e Posaçme në lidhje me likuidimin e të Paditurit të dytë dhe ka kërkuar pezullimin e të gjitha lëndëve në procedurë kundër tij. Megjithatë, AKP-ja nuk ka arritur që të ofrojë asnjë provë

për të mbështetur njoftimin e supozuar të më hershëm, ndërsa Zyra e Regjistrimit e Dhomës së Posaçme nuk ka ndonjë të dhënë të tillë të regjistruar.

Prandaj, Trupi Gjykues konsideroi se njoftimi që i Padituri i dytë është në likuidim dhe kërkesa për pezullimin e të gjitha lëndëve në procedure kundër tij është regjistruar për herë të parë në DHPGJS-së më 28 gusht 2009.

Më 29 qershor 2010, Trupi Gjykues e ka refuzuar padinë kundër të Paditurit të dytë si të papranueshme, në bazë të nenit 9 të Rregullores së UNMIK-ut 2005/18 lidhur me Rregulloren e UNMIK-ut 2005/48, siç është interpretuar nga Kolegji i Ankesave te DHPGJS-së në aktvendimet e tij ASC-10-0014 dhe ASC-09-0075.

Trupi Gjykues e ka refuzuar padinë gjithashtu kundër të Paditurit të parë, duke u arsyetuar se "fakti që padia kundër të Paditurit të dytë duhet të refuzohet si e papranueshme rrjedhimisht çon drejt refuzimit të padisë kundër të Paditurit të parë, e cila de facto është administratore e të Paditurit të dytë, e që nuk ka asnje legjitimitet të ndarë pasiv përvèç asaj që e ka i Padituri i dytë" dhe gjithashtu kundër të Paditurit të tretë, Ndër e Re, duke vlerësuar se DHPGJS-ja nuk ka juridikSION ndaj "kompanive private, të cilat aktualisht nuk janë apo nuk kanë qenë nën autoritetin administrativ të Agjencisë (...)".

Aktvendimi i Trupit Gjykues i është dorëzuar me kohë Paditësve më 10 korrik 2010.

Më 24 gusht 2010, Paditësit kanë ushtruar një ankesë ndaj Kolegjit të Ankesave të DHPGJS-së, duke kërkuar të anulohet aktvendimi i kontestuar dhe të vendoset mbi lëndën.

### **Arsyetimi Ligjor**

Ankesa është e bazuar. Aktvendimi i atakuar duhet të anulohet **pjesërisht** dhe Trupi Gjykues duhet të urdhërohet që të rigjykojë lëndën në bazë të mendimit ligjor të Kolegjit të Ankesave të dhënë si më poshtë.

Aktvendimi i Trupit Gjykues për të refuzuar padinë kundër Paditësit të tretë si të papranueshme, është dashur të anulohet. Mendimi Ligjor i Trupit Gjykues në lidhje me pranueshmërinë e padisë kundër të Paditurit të dytë ka qenë korrekt (ASC-10-0014, ASC-09-0075, e cekur siç duhet nga ana e Trupit Gjykues). Aktvendimi për të refuzuar padinë kundër të Paditurit të parë ka qenë korrekt në rezultat, por jo edhe në arsyetim. Aktvendimi në lidhje me të Paditurin e parë dhe të dytë duhet të vërtetohet.

Trupi Gjykues gabimisht ka vendosur të refuzojë padinë *in toto* si të papranueshme duke konsideruar se padia është parashtruar pas njoftimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 28 gusht 2009 në lidhje me kërkesën për pezullim të procedurës.

Trupi Gjykues në aktvendimin e vetë nuk e merr në konsideratë në mënyrë të mjaftueshme çështjen se kush mund të jetë i Paditur në lëndën në fjalë si dhe dallimin në mes të pranueshmërisë dhe meritave të padisë. Nëse do ta kishte bërë këtë, do ta kishte refuzuar padinë si të papranueshme vetëm kundër të Paditurit të dytë.

Paditësit në padinë e tyre kërkojnë nga DHPGJS-ja që të obligojnë Agjencinë Kosovare të Privatizimit, NSH [REDACTED] dhe Ndërmarrjen e Re që të njohin të drejtat e tyre të pronësisë në lidhje me një ngastër të caktuar të tokës.

Sa i përket të Paditurit të parë, "Agjencia" (dhe, sipas interpretimit të dhënë nga ana e Kolegjit të Ankesave në një sërë shembujsh të tjera, kjo vlen edhe për AKP-në) mund të qëndrojë si e paditur në vetvete vetëm në paditë për nenin 4.1 lit a), b) dhe e) të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4.

Në padinë në fjalë, padia ka të bëjë me njohjen e të drejtave të pronësisë, prandaj, sipas lit. d), i paditur mund të jetë vetëm një Ndërmarrje apo Korporatë, ndërsa Agjencia mund të jetë vetëm Administratore (sipas Nenit 5.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4).

Prandaj, Agjencia nuk mund të jetë e paditur në lëndën në fjalë në asnjë mënyrë; prandaj ka qenë korakte që të refuzohet si e papranueshme padia

kundër AKP-së, por jo bazuar në mungesë të legjimititetit pasiv (në këtë rast do të duhej të refuzohej si e papranueshme), por bazuar në Nenin 28.2 lit.c të UA të UNMIK-ut 2008/6).

Sa i përket të Paditurit të tretë, mendimi ligjor i Trupit Gjyques në lidhje me mungesën e juridikzionit të DHPGJS-së mbi ndërmarrjet private, nuk mund të zbatohet.

DHPGJS-ja mund të ketë juridikSION gjithashtu mbi Ndërmarrjet e Reja, sipas Nenit 4.1 lit d) të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4. Një Ndërmarrje e Re themelohet nga Agjencia në këtë mënyrë: Agjencia, si përfaqësuese/administratore e NSH-së e cila do të "transformohet" në një Ndërmarrje të Re, kujdeset për Regjistrimin e Ndërmarrjes së Re në pajtim me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/6. Aksionet e Ndërmarrjes së Re janë në pronësi të NSH-së përkatëse. Agjencia, sërisht duke vepruar si përfaqësuese/administratore e NSH-së tanë ia transferon Ndërmarrjes së Re asetet e NSH-së, duke përfshirë edhe pronën e patundshme. Vetëm pas këtij transferimi të aseteve, aksionet e Ndërmarrjes së Re i shiten/transferohen pronarëve të rinj. Prandaj, gjatë transferimit të pronës së patundshme, Ndërmarrja e Re, si një aset i vetë NSH-së, ka qenë nën autoritetin administrues të Agjencisë. Logjikisht rrjedh se edhe nëse padia është parashtruar pranë Dhomës së Posaçme, pas periudhës që një ndërmarrje e tillë (Ndër e Re) ka qenë nën autoritetin administrativ të Agjencisë, çështja në fjalë (padia për pronësi) ka lindur gjatë kohës sa Ndërmarrja e tillë ka qenë nën autoritetin administrativ të Agjencisë, pasi që pa dia për pronësi e pronarit të pretenduar "të vërtetë" kundër Ndërmarrjes së Re lind mu në momentin kur titullari i pronës i transferohet Ndërmarrjes së Re. Pronari i pretenduar dhe "i vërtetë" që nga momenti i transferimit të titullarit të pronësisë nga NSH-ja në Ndërmarrjen e Re (që është akoma nën pronësinë e NSH-së) nuk ka ndonjë opsjon tjetër, nëse do të dëshirojë që të kthejë pronën e tij se sa të padisë atë që është regjistruar si pronar/posedu es.

Prandaj, padia kundër të Paditurit të tretë nuk do të duhej të ishte refuzuar si e papranueshme por do të duhej të kishte vazhduar para Trupit Gjyques të DHPGJS-së, duke marrë në konsideratë që i Padituri i tretë është posedu es aktual (i regjistruar) i pronës së pretenduar.

*Shpenzimet / Tarifat Gjyqësore*

Tarifat Gjyqësore në vijim aplikohen për procedurat ankimore (shih ASC – 09 – 0072 et al.):

Tarifa Gjyqësore Neni 10.11 (parashtrimi i ankesës)	30 Euro
Tarifa Gjyqësore Neni 10.15 në lidhje me 10.21 (Aktvendimi i shkallës së dytë)	30 Euro
Gjithsej	60 Euros

Këto tarifa gjyqësore duhet të janë preliminare dhe të barten së bashku nga ana e Ankuesve, të cilët janë të obliguar të paguajnë shumën e përmendur pranë Dhomës së Posaçme.

Richard Winkelhofer, EULEX, Gjyqtar Kryesues	nënshkrimi
Torsten Koschinka, EULEX, Gjyqtar	nënshkrimi
Mr.sc. Sahit Sylejmani, Gjyqtar	nënshkrimi
Tobias Lapke, EULEX, Krye-regjistrues	nënshkrimi